



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL,  
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë . . 2025

PËR

**MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR BANESAT SOCIALE**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligji nr 22/2018,”Për Strehimin Social”, si dhe ligjin nr.9232 date 13.05.2004 Për programet sociale të strehimit “Neni.15 pika (3) njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies për trajtimit sipas programit të Banesave Sociale ,me propozim të kryetarit të Bashkisë Kolonjë.Këshillit Bashkiak në mbledhjen e dates \_\_\_/12/2025

1. Miratimin e sistemit të Pikëzimit”Për trajtimin sipas programit të banesave sociale me qira.
2. Miratimin e mënyrës së vlerësimit dhe llogaritjes sipas aneksit nr2
3. Miratimin e listës së dokumentacioneve që duhet të dorzojnë aplikantët
4. Ngarkohet Komisioni i Strehimit dhe Drejtoria e Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë.

Konc: Spec E. Xhelollari

Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O.Lifo

**KRYETARI  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**N/KRYETAR  
PETRO RISTO**



SISTEMI I KUSHTIMIT PER TRAJTIMIN SHALLIGORANIT TE BANESAVE ME QINA		
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
<b>1.1</b>	<b>KUSHTET E STREHIMIT</b>	<b>30</b>
A	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat I zbatimit të Aktit Normativ të Qeverisë nr.3 datë 01.08.2012 “Për lirimimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në ish-pronë e subjekte të shpronësuara” me apo pa kontratë nga ligji.	15
B	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat I fatkeqësive natyrore, ose të zbatimit të një vendimi gjyqësor	4
C	Banojnë në banesa me rrezik shembjeje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastreha.	4
Ç	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	4
D	Nuk disponojnë banesë në pronëso.	3
<b>1.2</b>	<b>KUSHTET FAMILJARE</b>	<b>20</b>
A	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t’u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror.	5
B	Familjet me më shumë se katër fëmijë ose familje një pondërore me fëmijë në ngarkim.	7
C	Çiftet e reja në moshë totale deri 60 (gjashtëdhjetë) vjeç	3
Ç	Familje të komunitetit rom dhe egjiptian	5
<b>1.3</b>	<b>KUSHTET SOCIALE</b>	<b>20</b>
A	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me Vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori.	5
B	Personat me status jetimi që nga çasti I daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.	5
C	Emigrant I kthyer, punëtor emigrant, që kanë në përbërje persona të cilët gëzojnë statusin e ish të përndjekurve politikë.	2
Ç	Familje të policëve të rënë në detyrë.	4
D	Viktima të dhunës në familje.	4
<b>1.4</b>	<b>KUSHTET EKONOMIKE</b>	<b>30</b>
A	Të ardhura nën 80% të të ardhurave mesatare.	15
B	Të ardhura nga 80% deri në 100% të të ardhurave mesatare.	10
C	Të ardhura nga 100% deri në 120% të të ardhurave mesatare.	5

## Aneksi 2

Mënyra e vlerësimit dhe llogaritja:

Shënim

Nuk mund të mblidhen brendapërbrenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Ç të kriterit 1.1;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2; dhe
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4

Pikët nga A deri në D të kriterit 1.3 mund të mblidhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

- a) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;
- b) Vetëm pikën C;

c) vetëm pikën D,

Pika B mund të mblidhet vetëm me pikën A.

Pika C mund të mblidhet vetëm me pikën A.

Pika Ç mund të mblidhet me pikat A dhe B së bashku ose njëri prej tyre. Në total mbledhja e pikëve A, B dhe Ç duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL,  
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

**KOMISIONI I STREHIMIT**

**KOLONJË**

Lista e dokumentacionit që duhet të dorëzojnë aplikantët për përfitimin nga programet e strehimit:

- Çertifikata e lindjes së aplikantit dhe çertifikata e gjendjes familjare;
- Vërtetimin për vendbanimin në Bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;
- Vërtetimin e të ardhurave neto dhe bruto (vërtetim punësimi nga punëdhënësi) shoqëruar me vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- Dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë antarët e vetë të punësuarë të familjes;
- Vërtetimin nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësisë të qeverisjes vendore për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- Vërtetimin nga zyra e punësimit të njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës të papunësisë;
- Vërtetimë nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;
- Vërtetimin nga zyra e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar I saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë;
- Vërtetimin nga zyra e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar I saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;
- Vërtetimin nga zyra e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figuron e rregjistruar asnjë prone, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet ,që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi, për të gjithë anëtarët e familjes;
- Dokumentin zyrtar të celebrimit dhe çertifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës ,për çiftet e reja;
- Vendimin e gjykatës, që I lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara, shoqëruara, shoqëruar me vërtetimin nga zyra e përmbarimit për masën e pensionit që përfitojnë fëmijët;
- Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qënë I strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror I autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- Vërtetimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara ,që trajtohen sipas shkronjës "I" ,të shkronjës "c", të nenit 5, të ligjit

m.7252, datë 15.05.2007, për programin social për shtetëtorët e bashkëve të zonave urbane, I ndryshuar;

- Nëse jetoni në një banesë me kushte jot ë mira ose që rrezikon shembje, kopja origjinale e vërtetimit të lëshuar nga Shërbimet Teknike të Bashkisë.
- Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, ”puntor emigrant” dhe azilkërkues”;

\*Vërtetim nga zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit,ose

\*Vërtetim I marrë pranë zyrave të punës.

-Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje:

\*Urdhri I mbrojtjes I lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor,seksioni familjar(Fotokopje e njuhësuar me origjinalin),ose

\*Vërtetim të marrë nga qendra kombëtare e shërbimit të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunësnë familje e ngritur nga Ministria e Punëve Çashtjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ose

\*Dokumentacioni përkatës mjekësor I miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe raporti mjekësor I lëshuar nga shërbimet e urgjencës dhe qendrat shëndetësore ne bashki dhe komuna,ose

\*Vërtetimin nga strukturat e shërbimit social,qëndrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës pranë njësive të qeverisjes vendore.

-Dokumenti I lëshuar nga institucionet përkatëse për familjet e komunitetit rom /egjiptjanë.

Konc: Spec E. Xhelollari  
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P O.Lifo

**KRYETARI  
ERION ISAI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
N/KRYETAR  
PETRO RISTO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL,  
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. 7134 Prot

Ersekë, më 12.12.2025

RELACION  
PËR

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ Datë . . . 2025

PËR

MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR BANESAT SOCIALE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr 22/2018, “Për Strehimin Social”, Neni.15 pika(3) Njësitë e Vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendor”, VKM nr.362, datë 29.05.2019 “ Për kriteret e dhënies për trajtimin e sistemit të pikëzimit për banesat sociale, Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve të paraqesë në Këshillin Bashkiak për Miratim sistemin e pikëzimit dhe dokumentat e nevojshëm për përfitimin e Banesave Social.

Konc: Spec E. Xhelollari  
Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O.Lifo

KRYETARI  
ERION ISAI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETAR  
PETRO RISTO

